



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT KORÇË

VENDIM Nr. 71 datë 24.07.09

PËR MIRATIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE DHE
SHPËRNDARJEN E REZULTATIT FINANCIAR TË VITIT 2008 TË
SH.A "UJËSJELLËS KANALIZIME" KORÇË

Këshilli Bashkiak në zbatim të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" Neni 135, pika 2 gërma dh, gërma e, si dhe të Statutit të Sh.A UKKO Neni 28, pasi u njoh me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë Nr. 2 mb 09/03 datë 30 Maj 2009 dhe pasi shqyrtoi kërkesën për miratim të pasqyrave financiare dhe shpërndarjes së rezultatit financiar të vitit 2008 të Drejtorisë dërguar me shkresë Nr. Prot. 182, datë 24.06.2009,

VENDOSI

1. Të miratojë pasqyrat financiare dhe shpërndarjen e rezultatit të Shoqërisë për vitin 2008.

Fitimi i ushtrimit	5.237.323 lekë
Rezervë ligjore 5%	261.866 lekë
Divident 10 %	523.732 lekë
Rezervë zhvillimi 85%	4.451.725 lekë


2. Derdhja e Dividentit të bëhet sipas tabelës më poshtë:

Divident 10 % i ndarë në:	523.732 lekë
10 % Dega tatim taksa	52.373 lekë
90% Bashkia Korçë	471.359 lekë

3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

GJERGJI PENDAMINI



Dixhitalizuar nga Qendra ÇIP
www.infocip.org